

RAPORTI FINANCIAR DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e Burimit dhe Përdorimit të Fondeve	5
Shënimet e Pasqyrës së Burimeve dhe Përdorimit të Fondeve	6
Shtojcat	
SHTOJCA 1 Asetet Fikse	14

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Asociacionit të Komunave të Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar Raportin Financiar shoqërues të Asociacionit të Komunave të Kosovës ("OJQ"), të cilat përfshijnë pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019, dhe shënime të raportit financiar, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, raporti shoqërues financiar paraqet në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe shpenzimet e paguara nga Asociacioni i Komunave Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019, në përputhje me bazën e kontabilitetit siç përshkruhet në shënimin 2 të raportit financiar.

Bazat mbi Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë të përshkruara më tej në seksionin e Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Raportit Financiar, të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga OJQ në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) që janë relevante në auditimin tonë të raportit financiar në Republikën e Kosovës. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtim me Kodin BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisje për Raportin Financiar

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të raportit financiar në përputhje me bazën e kontabilitetit siç përshkruhet në shënimin 2 të raportit financiar dhe për kontrollin e brendshëm siç e përcakton menaxhmenti si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e raportit financiar që është i lirë nga anomalitë materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Në përgatitjen e raportit financiar, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së OJQ-së për vazhdueshmërinë, shpalosjen, nëse aplikohet, çështjet që lidhen në vazhdueshmërinë dhe duke përdorur këtë si bazë të kontabilitetit përveq nëse menaxhmenti synon të likuidojë OJQ-në, të pushojë operacionet, ose nuk ka asnjë alternative reale tjetër përveç kësaj.

Personat e ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të OJQ-së.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Raportit Financiar

Objektivi jonë ka për bazë të marrim siguri të arsyeshme nëse raportet financiare si tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të përpilojmë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme nënkupton një nivel të lartë të sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me ISA gjithmonë do të zbulojë një anomali materiale, kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose të grupuara, ato mund të kenë ndikim në vendimet ekonomike që merren nga përdoruesit në bazën të këtyre raporteve financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale të raportit financiar, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe zbatojmë procedura të auditimit të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, për të dhënë një bazë mbi opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më e lartë se sa nga ajo që rrjedh nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjen e fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të OJQ-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e OJQ-së për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në raportin financiar, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që OJQ-ja të të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e raportit financiar, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse raporti financiar paraqet transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k

Prishtinë, Kosovë

5 Mars 2020


Astrit Kelmendi

Auditor Ligjor

PASQYRA E BURIMEVE DHE PËRDORIMIT TË FONDEVE

	Shënimet	Për vitin e përfunduar 31 Dhjetor	
		2019 (në EURO)	2018 (në EURO)
BURIMET E FONDEVE			
Fondet e donatorëve	3	673,473	378,901
Të hyrat nga pjesëmarrja e komunave	4	184,973	183,800
Të hyrat të tjera		185	-
TOTALI I FONDEVE NE DISPOZICION		858,631	562,701
PËRDORIMI I FONDEVE			
Zhvillimi i kapaciteteve	5	207,318	152,381
Shpenzimet e pagave	6	195,302	171,908
Lobimi / Avokimi	7	80,029	62,469
Komunikimet dhe publikimet	8	55,712	32,849
Pajisje dhe furnizime të zyrës	9	24,435	14,985
Shërbimet e zyrës	10	17,729	19,062
Shpenzime të tjera	11	14,224	10,514
Shpenzime të udhëtimit	12	11,083	11,590
Shpenzimet kontigjente	13	-	2,997
Totali i Shpenzimeve		605,832	478,755
Suficiti / (Deficiti) i fondeve të marra mbi shpenzimet		252,799	83,946
Fondet e kthyera tek donatorët			-
Suficiti i fondeve		252,799	83,946
Gjendja fillestare e parasë së gatshme dhe ne bankë		223,685	139,739
Gjendja e parasë së gatshme dhe në bankë në fund të periudhës	14	476,484	223,685

Ky raport financiar është miratuar nga Bordi më 3 Mars 2020 dhe u nënshkrua në emër të tyre nga:


 Sazan Ibrahim
 Drejtor Ekzekutiv




 Mexhit Shaqiri
 Menaxher Financiar

SHËNIMET NË PASQYRËN E BURIMEVE DHE PËRDORIMET E FONDEVE

1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Asociacioni i Komunave të Kosovës ("Asociacioni" ose "AKK") është organizatë kryesore jo-qeveritare (OJQ) e regjistruar në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike të Republikës së Kosovës, departamenti për regjistrim dhe ndërlidhje të OJQ-ve më 17 dhjetor 2002 me numër të regjistrimit 5101800-1.

Misioni

Misioni i Asociacionit është që të krijojë qeverisje lokale efikase, të qëndrueshme dhe demokratike përmes performancës së kualitetit të lartë në shërbimin e nevojave të qytetarëve të saj.

Synimet

Asociacioni është një interes i përbashkët i pjesëmarrësve në kushtet dhe rrethanat në të cilat vepron.

Asociacioni ka karakter profesional, në asnjë rast politik, dhe ka si obligim demokratizimin e mëtejshëm të shoqërisë kosovare.

Asociacioni do të jetë organizëm i fortë midis pushtetit lokal dhe atij qendror, duke i mbrojtur kompetencat e komunave nga tendencat centraliste si dhe avancimin e tyre në përputhje me ligjet në fuqi.

Asociacioni përveç demokratizimit të shoqërisë (përmes demokratizimit të institucioneve), do të punojë edhe në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, forcimin e bashkëpunimit mes komunave si dhe në integrimin e komuniteteve në shoqërinë kosovare.

Qëllimi kryesor i Asociacionit është qeverisja e mirë dhe e suksesshme në nivelin lokal, përgjatë angazhimit në të gjitha aspektet e jetës shoqërore.

Asociacioni ka për qëllim harmonizimin e niveleve të ndryshme të qeverisjes si dhe heqjen e paralelizmave të panevojshme, pavarësisht se prej nga vijnë këto.

Asociacioni do të bashkëpunojë dhe aderojë me asociacionet simotra evropiane – ndërkombëtare si dhe do të bazohet në Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale (neni 4, artikulli 6) ku thuhet: bashkësive lokale duhet t'u kërkohet mendimi, brenda mundësive, në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme, gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për çështjet që u përkasin drejtpërsëdrejti, duhet respektuar.

Objektivat

-Përmirësimin e strukturave legislative të vetëqeverisjes, efikasitetit praktik dhe implementimit të tyre;

-Stimulimin e decentralizimit të pushtetit, përmes mbështetjes praktike dhe bashkëpunimit mbi baza të barabarta, mes autoriteteve qendrore dhe lokale; Zgjerimin e mbështetjes publike për demokracinë lokale që përfshin qytetarët dhe komunitetin e biznesit dhe ngritjen e besimit në vetorganizimin e tyre dhe gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në qeverisjen lokale;

-Rritjen e numrit të kompetencave, njohurive dhe kapaciteteve të komunave për të siguruar cilësi të lartë dhe efektive në shërbimet lokale;

-Gjetjen e burimeve alternative financiare për komunat;

-Shfaqjen e faktit se Komunat e Kosovës janë të barabarta dhe kanë partneritet kompetitiv me autoritetet lokale në Evropë dhe në të gjithë botën;

-Përkrahja në zhvillimin e Asociacionit në përputhje me rrethet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

2 POLITIKAT E KONTABILITETIT

2.1 Baza e përgatitjes

Raporti financiar është përgatitur në përputhje me bazën kontabël të pranimit dhe pagesave në para të gatshme. Sipas parimit të pranimit dhe pagesave në para gatshme, të hyrat njihen kur pranohen e jo kur fitohen, dhe shpenzimet njihen kur paguhen dhe jo kur ndodhin. Kostot që lidhen me blerjen e aseteve fikse nuk janë të kapitalizuara.

Të gjitha të dhënat në raportin financiar janë të shprehura në Euro (valuta ligjore në territorin e Kosovës). Sipas nevojës, shifrat krahasuese janë ri-klasifikuar në mënyrë që të jenë në përputhje me prezantimin e vitit aktual.

3 FONDET E DONATORËVE

	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
SDC	250,000	311,339
GIZ	219,422	32,497
SIDA	139,251	-
NALAS	60,700	32,515
CARITAS	4,100	2,550
Totali i Fondeve të Donatorëve	673,473	378,901

Informacioni i mëposhtëm është siguruar vetëm për kontratat e projektit prej të cilave OJQ-ja ka marrë fonde gjatë vitit 2019 dhe 2018. Projektet janë dhënë në mënyrë të shumave të pranuar gjatë vitit 2019 dhe jo sipas vlerës së përgjithshme të kontratës.

- SDC Konfederata Zvicerane e përfaqësuar nga Departamenti Federal Zviceran i Punëve të Jashtme, duke vepruar nëpërmjet Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran – Mbështetja Institucionale e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Projekti i AKK-së "Mbështetje Asociacionit të Komunave të Kosovës", u miratua nga SDC dhe marrëveshja u nënshkrua më 19 Dhjetor 2018. Periudha e zbatimit të projektit është nga 1 janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2021. Qëllimi i drejtpërdrejtë i vazhdimit të përkrahjes institucionale të SDC-së është të sigurojë që AKK-ja të mbetet akteri kryesor i pranuar që (i) mbron me sukses interesat e komunës në raport me qeverinë qendrore; dhe (ii) i shërben profesionalisht nevojave të komunave, të cilat financojnë aktivitetet e saj bazë. Gjatë vitit 2019 dhe 2018, AKK-ja ka pranuar një shumë totale prej 250,000 Euro dhe 250,000 euro, respektivisht nga kjo kontratë.

Projekti i AKK-së "Mbështetja Institucionale e Asociacionit të Komunave të Kosovës", u miratua nga SDC dhe marrëveshja u nënshkrua më 23 Dhjetor 2013, u ndryshua më 17 Nëntor 2017. Periudha e zbatimit të projektit është nga 1 janar 2014 deri më 28 Shkurt 2018. Qëllimi i këtij projekti është e lidhur me vizionin e AKK-së e cila përfshin avokimin për komunat në nivel qendror duke u shërbyer nevojave të komunave anëtare të saj. Gjatë vitit 2018, AKK-ja ka pranuar një shumë totale prej 61,339 euro nga kjo kontratë.

GIZ- Deutsche Gesellschaft für international Zusammenarbeit GMBH

Projekti i AKK-së "Fuqizimi i strukturave komunale për menaxhimin e Mbeturinave" është miratuar nga GIZ dhe marrëveshja është nënshkruar më 9 janar 2018. Periudha e implementimit ishte nga 1 janari 2018 deri më 31 mars 2019. Periudha e implementimit të kësaj kontrate është zgjatur deri më 31 Tetor 2019 përmes një aneks kontratë e cila është nënshkruar më datë 28 Gusht 2019. Qëllimi i këtij projekti ishte fuqizimi i strukturave komunale për menaxhimin e mbeturinave. Gjatë vitit 2019 dhe 2018, AKK-ja ka pranuar një shumë totale prej 29,610 Euro dhe 19,120 Euro, respektivisht, nga kjo kontratë.

Projekti i AKK "Fondet Rajonale të Hapura për Evropën Juglindore" u miratua nga GIZ dhe marrëveshja u nënshkrua më 7 shtator 2018, u ndryshua më 17 Dhjetor 2018. Periudha e zbatimit të këtij projekti është nga 10 shtatori 2018. Shënime shpjeguese nga 1 deri më 14 janë pjese përbërëse e këtij raporti

deri më 15 Korrik 2019. Qëllimi i këtij projekti ishte përmirësimi i kapaciteteve të komunave të Kosovës në fushën e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane. Gjatë vitit 2018, AKK ka pranuar një shumë totale prej 3,070 euro nga kjo kontratë.

Projekti i AKK-së "Projekti i Efiçencës së Energjisë në Kosovë" u miratua nga GIZ dhe marrëveshja u nënshkrua më 7 shtator 2018, u ndryshua më 2 Nëntor 2019 në lidhje me zgjatjen e projektit. Periudha e zbatimit të këtij projekti është nga 7 Shkurt 2018 deri më 15 Nëntor 2019. Qëllimi i këtij projekti ishte krijimi i një moduli të qëndrueshëm të zhvillimit të kapaciteteve në AKK Sistemet Komunale të Menaxhimit të Energjisë për komunat anëtare për të mundësuar zbatimin e Politikave të EE për Nivel Lokal. Gjatë vitit 2019 dhe 2018, AKK-ja ka pranuar një shumë totale prej 30,862 Euro dhe 10,307 Euro, respektivisht, nga kjo kontratë.

Projekti i AKK-së "Zhvillimi i kapaciteteve në arsimin bazë" u miratua nga GIZ dhe marrëveshja u nënshkrua më 15 Nëntor 2019. Periudha e zbatimit të këtij projekti është nga 5 Nëntor 2019 deri më 30 Nëntor 2019. Qëllimi i këtij projekti ishte promovimi dhe forcimi i rolit të kolegjiëve për Arsim. Gjatë vitit 2019, AKK-ja ka pranuar një shumë totale prej 6,760 Euro nga kjo kontratë.

Projekti i AKK-së "Drejt përmirësimit të transportit dhe lëvizshmërisë në komunat e Kosovës" u miratua nga GIZ dhe marrëveshja u nënshkrua më 14 Qershor 2019. Periudha e zbatimit të këtij projekti është nga 14 Qershor 2019 deri më 30 Prill 2020. Qëllimi i këtij projekti ishte përmirësimi i transportit dhe lëvizjen në nivelin lokal në Kosovë. Gjatë vitit 2019 AKK-ja ka pranuar një shumë totale prej 39,945 Euro nga kjo kontratë

Projekti i AKK-së "Mbështetja e Komunave të Kosovës përmes AKK-së në lehtësimin e zbatimit të politikave të EE në nivelin lokal" u miratua nga GIZ dhe marrëveshja u nënshkrua më 16 Dhjetor 2019. Periudha e zbatimit të këtij projekti është nga 02 Dhjetor 2019 deri më 30 Qershor 2020. Qëllimi i këtij projekti ishte ndërtimi i kapaciteteve për stafin lokal në komuna në disa fusha: në trajnimin në klasë, formate të ndryshme shkëmbimi (nën qendrën e trajnimit) dhe duke siguruar një platformë elektronike të mësimi. Trajnimet do të bëhen posaçërisht për të mbuluar fushat e ndryshme përkatëse midis atyre që do të përqendrohen në përmirësimin dhe bërjen e sistemit të qëndrueshëm të menaxhimit të energjisë të Komunës. Gjatë vitit 2019, AKK-ja ka pranuar një shumë totale prej 112,245 Euro nga kjo kontratë.

SIDA- Rritja e Kapaciteteve të Zyrtarëve të Zgjedhur Lokal drejt Ofritit të Shërbimeve në Komunat e Kosovës, Marrëveshje Donacioni ndërmjet Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Zhvillimit, SIDA dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Projekti i AKK-së "Zhvillimi i Kapacitetit të Zyrtarëve Komunal të Zgjedhur dhe të emëruar" u miratuar nga SIDA dhe marrëveshja është nënshkruar më 30 korrik 2020. Periudha e zbatimit të projektit është nga 1 gusht 2019 deri më 31 dhjetor 2022. Objektivi i AKK-së në lidhje me këtë projekt është (i) Përkushtimi në kërkesat e zyrtarëve lokalë të zgjedhur dhe të emëruar në komuna duke u ofruar atyre një përvojë të shkëlqyer mësimore (ii) Të shërbej si një qendër lehtësimi për shkëmbimin e përvojave ndërmjet komunave (iii) Avancimi sektorial i trajnimit përmes një programi inovativ i cili plotëson potencialisht kërkesa të reja të stafit dhe komuniteteve të zgjedhura lokale (iv) Zhvillimi i platformave të shumëfishta për trajnime në përputhje me Standardet ISO. (v) Ndihmon komunat në krijimin e një dokumenti monument institucional bazuar në praktikën më të mira dhe t'i kenë ato në dispozicion gjerësisht (vi) Partneritet me aktorët përkatës për t'i ofruar stafit komunal mundësi më të mira trajnime të përshtatura për nevojat e tyre. Gjatë vitit 2019, AKK ka marrë një shumë totale prej 139,151 EUR nga kjo kontratë.

- **NALAS- Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore.**

Projekti i AKK-së "ndërtimi i kapaciteteve për dhënien e CD-së së pare në kornizën e zhvillimit të kapaciteteve regjionale të rrjetit në sektorin e ujit dhe sanitarisë (RCDN)" u miratua nga NALAS dhe marrëveshja u nënshkrua më 27 Korrik 2018. Qëllimi primar i këtij projekti ishte përfshirja e asociacioneve partnere (LGA dhe APUCS) në bashkëpunim të përbashkët për shpërndarjen e CD-së nëpërmjet RCDN. Periudha e zbatimit të projektit është 1 Gusht 2018 deri më 20 Shkurt 2019. Projekti i njëjtë ka vazhduar edhe në vitin 2019, periudha e implementimit të projektit është 01 Qershor deri më 20 Shkurt 2020. Gjatë vitit 2019 dhe 2018, AKK ka pranuar një shumë total prej 54,700 dhe 24,900 Euro, respektivisht, nga kjo kontratë.

Projektit i AKK-së "Asistent Menaxhues i Njohurive Kombëtare" u miratua nga NALAS dhe marrëveshja u nënshkrua më 30 Dhjetor 2015. Qëllimi i projektit ishte për të mundësuar anëtarët e NALAS-it që të përpunojnë në mënyrë efektive informacionin në lidhje me qeveritë lokale, të sigurojnë të dhëna të nevojshme për qendrën e njohurive të NALAS-it, qasje të përmirësuar në informacionet specifike shtetërore dhe përdorimin e njohurive të NALAS-it nga qeveria në EIL në mënyrë që të aplikojnë praktikatat më të mira nga rajoni. Periudha e zbatimit të projektit është nga 1 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor të vitit 2019. Gjatë vitit 2019 dhe 2018 AKK-ja ka pranuar një shumë totale prej 6,000 Euro dhe 6,000 Euro, respektivisht, nga kjo kontratë.

Projekti i AKK-së "Financat e Komunave Vetëvlerësimi i shkallëzuar deri në EIL", u miratua nga NALAS dhe marrëveshja u nënshkrua më 3 Tetor 2017. Qëllimi i projektit ishte që të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të financave të komunave dhe transparencën në vendbanimin e përhershëm të marrësit për të forcuar kapacitetet të marrësit – Asociacionit të Pushtetit Lokal (LGA), për të zbatuar mbështetje teknike për qeveritë lokale anëtare në zbatimin global të Bankës Botërore: Vetëvlerësimin të financave të komunave. Periudha e zbatimit të projektit është nga data 1 Shtator 2017 deri më 30 Nëntor 2017. Gjatë vitit 2018, AKK-ja ka pranuar një shumë totale prej 1,615 nga kjo kontratë.

- **CARITAS Switzerland**

Projekti i AKK-së "Vendosja e standardeve parashkollore të cilësisë së lartë duke përfunduar arsimin, shkencën dhe ekonominë (SHPRESE)" u miratua nga CARITAS dhe marrëveshja u nënshkrua më 1 shtator 2018. Periudha e zbatimit të këtij projekti është nga 7 shtatori 2018 deri më 30 qershor 2022. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti ishte të kontribuonte në përmirësimin e arsimit cilësor dhe ofrimin e shërbimeve në PPE në Kosovë. Gjatë vitit 2019 dhe 2018, AKK-ja ka pranuar një shumë totale prej 4.100 Euro dhe 2,550 Euro, respektivisht, nga kjo kontratë.

4	TË HYRAT NGA PIESËMARRJA E KOMUNAVE	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
	PRISHTINË	19,890	19,890
	PRIZREN	17,778	18,378
	FERIZAJ	14,583	6,000
	SKENDERAJ	13,532	4,240
	PEJË	9,645	9,645
	GJAKOVË	9,456	16,941
	GJILAN	9,018	10,527
	PODUJEVË	8,850	8,850
	DRENAS	8,780	8,780
	MITROVICË	7,100	7,100
	VUSHTRRI	6,987	6,987
	SUHAREKË	5,972	11,295
	LIPJAN	5,761	11,521
	RAHOVEC	5,621	6,626
	MALISHEVË	5,461	455
	KLINË	5,000	4,000
	VITI	4,699	4,699
	ISTOG	3,929	3,929
	KAMENICË	3,609	3,609
	DRAGASH	3,400	3,400
	KAÇANIK	3,341	3,482
	FUSHE KOSOVË	3,271	3,483
	SHTIME	2,732	2,732
	OBILIQ	2,155	2,155
	GRAÇANICË	1,068	1,068
	HANI ELEZIT	940	940
	NOVOBERDE	673	1,346
	JUNIK	608	608
	MAMUSHË	551	551
	RANILLUG	387	387
	PARTESH	179	179
	Total të hyrat nga Pjesëmarrja e Komunave	184,973	183,800

Sipas Vendimit të Kuvendit të Asociacionit të datës 14 Mars 2014 dhe në përputhje me nenin 4, pika 4.14.2 të Statutit të AKK-së, anëtarët e Asociacionit (komunat) janë të detyruar të paguajnë një tarifë mujore për anëtarësim, të miratuar nga Kuvendi i Asociacionit. Kjo përgjegjësi është disbursuar nga secila komunë sipas formulës së re të propozuar për kuotat e anëtarësimit të AKK-së. Tarifa e pagesës së anëtarësimit është vendosur të jetë 0.10-euro cent për kokë banori duke përdorur si kriter bazë të numrit të popullsisë në komunat e Kosovës.

Për fund vitin 31 Dhjetor 2019, Asociacioni ka arkëtuar një shumë prej 184,973 euro si tarifë e anëtarësimit nga komunat (kurse për vitin e mbyllur Dhjetor 2018: 183,800 euro). Kjo shumë shërben si një buxhet operativ i Asociacionit, dhe është përdorur për mbulimin e shpenzimeve operative dhe administrative të zyrës së Asociacionit.

5	ZHVILLIMI I KAPACITETEVE	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
	Zhvillimi i kapaciteteve të Zyrtarëve Komunalë	55,339	-
	Implementimi i trajnimeve të ndryshme (Modulet)	52,002	-
	Vizita studimore	41,714	9,918
	Zhvillimi i analizave profesionale/Konsulenca	33,678	5,975
	Takimet dhe konferencat ndërkombëtare	11,597	17,066
	Kostot për startup (Qendra e Trajnimit)	7,988	-
	Trajnimet i stafit	5,000	5,000
	Trajnimi për anëtarët e rinj të Asambleve Komunale	-	49,598
	Ngritja e kapaciteteve-Implementimi i Strategjisë së Trajnimeve	-	38,965
	Punëtori të ndryshme në lidhje me ngritjen e kapaciteteve	-	25,859
		207,318	152,381

6	SHPENZIMET E PAGAVE	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
	Stafi i rregullt	129,951	131,848
	Shpenzimet të tjera të lidhura me stafin (tatimet dhe pensionet)	31,628	28,575
	Konsulentët dhe ekspertët e jashtëm	33,723	11,485
		195,302	171,908

Të përfshira në shpenzimet e pagave janë të gjithë të punësuarit e rregullt, të punësuarit me gjysmë orari, të kontraktuar, dhe personeli tjetër për të cilën OJQ-ja ka deklaruar dhe paguar tatimet dhe kontributin pensional. OJQ-ja për vitin të përfunduar më 31 Dhjetor 2019 kishte mesatarisht 14 punonjës të rregullt dhe të tjerë të kontraktuar për muaj (për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018: 14 të punësuar).

7	LOBIMI/AVOKIMI	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
	Takimet e Kolegjiumeve	37,126	23,631
	Takimet dhe Konferencat Lokale	26,588	24,274
	Kuvendi i AKK-së	7,292	7,600
	Përfaqësimi	4,723	2,964
	Anëtarësimi (NALAS, ALDA)	4,300	4,000
		80,029	62,469

8	KOMUNIKIMET DHE PUBLIKIMET	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
	Publikime të ndryshme (Deklarata Parimore etj.)	34,326	15,617
	Buletini i AKK-së	9,000	9,000
	Shërbime përkthimi (Pajisje dhe përkthim simultan)	11,410	6,600
	Web-faqja e AKK / IT	976	1,632
		55,712	32,849

9 PAJISJET DHE FURNIZIMET E ZYRËS

	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
Pajisje të zyrës (pajisje kompjuterike etj)	6,953	2,839
Pajisjet për zyrë (letra dhe materiale tjera)	6,624	3,860
Artikuj të tjerë konsumues për zyre	4,144	3,868
Pajisje tjera (mobile, etj)	3,570	1,854
Artikujt higjienikë për zyrën	3,145	2,564
	24,436	14,985

10 SHËRBIMET E ZYRËS

	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
Qiraja e Zyrës	8,244	8,244
Shërbimet Postare	2,811	4,092
Energjia Elektrike	2,100	2,029
Mirëmbajtja e Pajisjeve (servisimi)	1,533	1,799
Interneti	1,525	1,525
Tatimi në qira	756	756
Mirëmbajtja e Ndërtesës/Sigurimi	360	360
Uji	400	257
	17,729	19,062

11 SHPENZIME TË TJERA

	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
Mirëmbajtje e automjeteve	3,038	4,359
Shpenzimet për shërbime profesionale	3,600	3,300
Shpenzime të tjera	3,081	3,007
Provizioni i bankës	1,285	634
Karburant për gjenerator	79	290
	11,083	11,590

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS
 RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019

12	SHPENZIMET E UDHËTIMIT	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
	Karburant për automjete	7,516	5,520
	Transporti (Bileta udhëtimi, etj)	6,261	4,889
	Viza (taksat/shpenzimet)	406	60
	Sigurimi i shëndetit në udhëtim	41	45
		14,224	10,514
13	KONTIGJENCAT	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
	Kontigjencat	-	2,997
		-	2,997
14	PARAJA E GATSHME DHE NË BANKË	2019 (në EUR)	2018 (në EUR)
	Paraja në bankë	476,472	223,661
	Paraja në Dorë	12	24
		476,484	223,685

SHTOJCA 1 ASETET FIKSE

Përshkrimi	Viti i blerjes	Blerësi / Donatori	Vlera e blerjes
Skanues i shpejtë i dokumenteve	1-Aug-06	EAR	3,925
Kompjuterë desktop	1-Aug-06	EAR	2,869
Lap Top kompjuterat	1-Aug-06	EAR	1,518
Projektor Ekrani Portable	1-Aug-06	EAR	277
Kopjues CD	1-Aug-06	EAR	3,090
UPS	1-Aug-06	EAR	284
Pajisjet e Përkthimit Simultant	1-Aug-06	EAR	27,916
Kamera dixhitale	1-Aug-06	EAR	325
projektor	1-Aug-06	EAR	1,534
Kompjuterë desktop	1-Nov-09	GTZ	3,786
Lap Top kompjuterë	1-Nov-09	GTZ	966
Projektori Toshiba	1-Nov-09	GTZ	1,241
Printer	1-Nov-09	GTZ	509
Gjenerator zyre	6-Oct-14	AKM	950
Automjet (PASAT)	9-Aug-14	AKM	19,500
Kompjuterë desktop	1-Sep-09	AKM	1,830
Lap Top kompjuterë	1-Sep-09	AKM	570
Serveri AKM	1-Oct-09	AKM	1,300
Makinë fotokopjuese	1-Sep-09	AKM	1,590
Laptop DELL Inspiron N5110	1-Dec-11	AKM	729
Canon T ALL GJITHA N O NJINE	1-Dec-11	AKM	266
Laptop TOSHIBA Satelitor	1-Oct-11	GIZ	639
PC Fujitsu	1-Jan-12	AKM	499
Makinë fotokopjuese	1-Jun-12	AKM	1,864
Kondicioner	1-Jun-12	AKM	435
Kondicioner	1-Jun-12	AKM	244
aparati fotografik	1-Jul-12	AKM	730
Shnaider (Rexel P185)	1-Jul-12	AKM	483
Sony TV	1-Nov-12	AKM	668
Gjenerator zyre	1-Dec-14	AKM	400
Monitor Fujitsu / Fujitsu PC I5 Esprimo P420	1-Aug-14	AKM	693
Llaptop Fujitsu I5 Libri i Jetës A544	1-Oct-14	AKM	515
Fletore Llaptop Fujitsu LB A555	1-Dec-15	AKM	525
Navigacion për veture (GARMIN GPS NUVI 55LM, EUROPE 2015)	1-Nov-15	AKM	180
Automjet	6-Jan-15	AKM/SDC	5,500
Smartphone Samsung, SN-G935 FZKASEE, E Zezë	16-May-16	AKM	859
Lap Top për zyre (Dell NB Inspiration, N5110 Intel)	1-Apr-16	AKM	490
Lap Top për zyre, LENOVO NB LM30	1-May-16	AKM	493
Pc dhe monitor për zyre, Fujitsu P556 E85, Monitor HP Compaq	1-Jul-16	AKM	850
Lap Top (Apple MacBook Pro)	18-Dec-17	AKM	1,195
Automjet	23-Mar-17	AKM/SDC	9,500
Centrale telefonike Panasonic	23-Jun-17	AKM	376
Apple MacBook Air 13 "/ 8/128	1-Nov-18	AKM/NALAS	1,099
Karriget e zyrave (14 karrige)	6-Nov-18	AKM/NALAS	560

APPENDIX 1 FIXED ASSETS(CONTINUED)

Description	Year of Purchase	Buyer / Donator	Purchase Price
Makinë fotokopjuese	22-Jan-19	AKM/NALAS	2,495
Samsung, SM-G960FZKDSEE DS BLACK	05-Feb-19	AKM	549
Lap top (Dell inspiration 15-3000 Series Intel Core	26-Mar-19	AKM/SDC	350
Grisëse Letrash Ideal 2445 CC 2x15mm	16-Jul-19	AKM/SDC	575
LAPTOP LENOVO IDEPAD 330-15KBR	28-Aug-19	AKM/SIDA	798
LAPTOP LENOVO IDEPAD 330-15KBR	29-Aug-19	AKM/SIDA	798
Projector Acer X1123H	7-Oct-19	AKM/SIDA	379
Samsung SM-970FZKDSEE	14-Nov-19	AKM	829
LAPTOP (Notebook HP 250 G7 i3-7020U/4GB/HDD 500GB)	5-Dec-19	AKM	315
LAPTOP (Notebook HP 250 G7 i3-7020U/4GB/HDD 500GB)	5-Dec-19	AKM	315
LAPTOP (Notebook HP 250 G7 i3-7020U/4GB/HDD 500GB)	5-Dec-19	AKM	315
LAPTOP (Notebook HP 250 G7 i3-7020U/4GB/HDD 500GB)	5-Dec-19	AKM	315
Karrige Zyre D68-1	30-Dec-19	AKM	66
Karrige Zyre D68-1	30-Dec-19	AKM	66
Karrige Zyre	30-Dec-19	AKM	180
Nxemje për Zyre (ELIND 3.5)	31-Dec-19	AKM	300
			112,417

